



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Lënda: Mbi Raportin e Monitorimit për janar - prill 2018

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", Ligjit Nr. 109, datë 30.11.2017 "Për Buxhetin e vitit 2018", pikës 101 të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”, është hartuar për shqyrtim dhe miratim nga Grup i Menaxhimit Strategjik, relacioni me shpjegimet përkatëse dhe formatet standarde, si pjesë e strukturës së raportit si vijon.

Monitorimi është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar. Në kuadër të Menaxhimit Financiar, monitorimit i kushtohet një vëmendje e veçantë si një nga 5 komponentët shumë të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm. Monitorimi për veprimtarinë institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për 4- mujorin e parë të vitit 2018, është kryer në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt të zërave të shpenzimeve në tërësi dhe jo mbi bazën e produkteve dhe aktiviteteve, pasi Kolegji i Posaçëm i Apelimit është institucion i ri dhe, si i tillë, operon në rrethana të veçanta (buxheti i vitit 2018 është viti i parë buxhetor, pa historik dhe tregues statistikorë, i paplanifikuar si pjesë e PBA-së 2018-2020).


Buxheti i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për vitin 2018, është miratuar si pjesë e buxhetit të shtetit me Ligjin Nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”. Detajimi i buxhetit të vitit 2018 për shpenzimet korente dhe shpenzimet kapitale paraqitet në pasqyrën e mëposhtme.

000/lekë

Kodi i institucionit	Programi	Llogaria ekonomike	Buxheti Vjetor 2018	Emërtimi	Pesha specifike e çdo zeri kundrejt buxhetit vjetor
1063003	03340	6000000	100,000	Pagat	65%
1063003	03340	6010000	8,000	Kontributi i sigurimeve shoqërore	5%
1063003	03340	6020000	20,000	Mallra dhe shërbime	13%

1063003	03340	2319999	26,000	Shpenzime kapitale	17%
TOTALI					100%
			154,000		

Pesha specifike e secilës llogari ekonomike mbi buxhetin total të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit paraqitet edhe në mënyrë grafike si më poshtë:



Në kuadër të monitorimit katërmujor po analizojmë realizimin e shpenzimeve korente (paga, sigurime shoqërore, blerje mallra shërbime) për periudhën progresive 4-mujore paraqitur si më poshtë.

Fondi total i miratuar për shpenzime korrente është 128,000 mijë lekë. Plani për periudhën 4/mujore është 42,400 mijë lekë dhe realizimi 22,590 mijë lekë ose 53%

000/lekë						
Programi	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Plani vjetor	Plani 4-mujor	Realizimi 4-mujor	% realizimit
03340	6000000	Paga	100,000	33,333	20,191	61%
03340	6010000	Kontributi i shoqërore dhe shëndetësore	8,000	2,667	1,449	54 %
03340	6020000	Mallra e shërbime	20,000	6,400	950	15%
		TOTAL	128,000	42,400	22,590	53%

I - Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Fondi i miratuar për paga, përbën 65% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2018. Realizimi i fondit të pagave si 4-mujor, kundrejt planifikimit të së njëjtës periudhë, është 61% . Sikundër vërehet edhe nga parashtrimi i shifrave, për këtë zë kemi mosrealizim të dukshëm, shkaqet e të cilit i argumentojmë sa më poshtë.

1. Strukturë e paplotësuar

Nga muaji qershor deri në fund të vitit 2017 u emëruan dhe filluan punë Gjyqtarët, Sekretari i Përgjithshëm dhe Sekretari i Kryetares gjithsej 9, nga 37 punonjës të miratuar në strukturë. Në 4- mujorin e parë të vitit 2018 rekrutimi paraqitet: janar 7 punonjës, shkurt 11 punonjës, mars 2 punonjës dhe prill 3 punonjës gjithsej, së-bashku me të rekrutuarit në vitin 2017, 32 punonjës nga 37 në strukturë. Numri mesatar i punonjësve për 4/mujorin e parë të vitit 2018 është 26 punonjës.

2. Ditë pune të paplota

Në varësi të datës së fillimit të punës, ka pasur punonjës që janë paguar me më pak se 22 ditë.

3. Planifikimi i vjetërsisë

Në pamundësi parashikimi të viteve të punës për punonjësit që do të punësoheshin përllogaritja e vjetërsisë është kryer duke marrë në konsideratë vitet maksimale të punës.

4. Mospagesa e vështirësisë

Gjatë periudhës katërmujore nuk është kryer pagesa për vështirësi për Këshilltarët Ligjorë dhe Ekonomik. Për këto pozicione është parashikuar vështirësi gjatë vitit në masën e tre pagave mujore.

II - Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore përbën 5% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2018. Realizimi i fondit të sigurimeve si 4-mujor, kundrejt planifikimit 4-mujor, është 19 % .Fondi i sigurimit është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, si rrjedhojë shkaqet e mosrealizimit të fondit të pagave vlejné dhe për këtë zë.

III - Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihet një gamë e gjerë mallrash dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e realizimit të veprimtarisë institucionale. Ky grup shpenzimesh përbën 13% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2018. Shpenzimet për llogarinë 602 (për mallra dhe shërbime) për 4 - mujorin janë realizuar në vlerën 950,000 lekë dhe në përqindje në masën 15% të buxhetit të planifikuar.

Në mënyrë analitike realizimi paraqitet në tabelën në vijim

në lekë

<i>MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA</i>	Realizimi 4-mujor
Materiale për funksionimin e zyrave (bojë për printer, fotokopje)	118,800
Të tjera materiale dhe shërbime speciale	56,193
Shpenzime për energji elektrike	707,746
Shpenzime për furnizimin me ujë.	10,000
Posta dhe shërbim korrieri + abonim në shtypin e shkruar	6,302
Shpenzime kompesimi për zyrtarët e zgjedhur (pasaportë diplomatike)	7,500

Shpenzime për deklarime të vonuara	43,627
TOTALI	950,168

-Në zërat “Shpenzime për energji elektrike” dhe “Shpenzime për furnizimin me ujë”, përkatësisht me vlerë 707,746 lekë dhe 10,000 lekë, janë pasqyruar shpenzimet për lidhjet e pikave dhe azhurnimet e rrjeteve, dhe jo konsumet, pasi ende nuk jemi futur në godinë dhe nuk kemi matje të konsumit.

-Në zërin “Shpenzime për deklarime të vonuara me vlerë 43,627 lekë”, përfshihet pagesa për interesat e gjobave, të marra për mosdeklarim në afat të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në sistem. Gjobat në vlerë 176,660 lekë ende nuk janë paguar. Lidhur me pagesën e gjobës ka patur komunikime zyrtare me Drejtorinë e Apelimit Tatimor, për apelimin e njoftimit të vleresimit tatimor. Me gjithë argumentat e parashtruara Drejtoria e Apelimit Tatimor ka vendosur: “Refuzimin e ankimit ndaj njoftimit vlerësimit për shkak se njuk është plotësuar kushti ligjor për pagesën apo vendosjen e garancisë bankare të kamatvonesave, brenda afatit të ankimit”.

-Aktualisht janë në proces likuidimi procedurat për furnizimin me tonera të institucionit (1,537 mijë lekë pa tvsh), furnizimin me ujë të pijshëm për personelin(100 mijë lekë pa tvsh), kancelari dhe letër (470 mijë lekë pa tvsh).

-Gjithashtu me marrjen e automjetit do të fillojë procedura e prokurimit për karburant për automjet dhe gjenerator në vlerën (700 mijë lekë pa tvsh). Konkretisht, për efekt prokurimi është parashikuar karburant për 11 muaj për automjetin, duke konsideruar një shpenzim mesatar rreth 230 litra në muaj (2600 km në muaj) ose 2500 litra gjithsej. Sa i takon konsumit të karburantit për gjeneratorin është mbajtur në konsideratë fakti se vetëm për mirëmbajtjen e tij, për 11 muaj nevojiten 275 litra (25 litra/ore)gjeneratorit si dhe parashikimi për rreth 20 ditë ndërprerje në 11 muaj (çdo ndërprerje zgjat rreth 40min ose 14 ore në total) me një konsum total rreth 721 litra.

Niveli i ulët i realizimit, në masën 15% është diktuar nga fakti se veprimtaria institucionale e Kolegjtit të Apelimit nuk është kryer në ambjentet e miratuara me VKM për këtë qëllim. Me akomodimin në këto ambiente do të kryhen edhe pagesat për shpenzime utilitare, si: telefoni fikse, energji elektrike, ujë, shërbime të ndryshme për mirëmbajtje etj. Një situatë më të plotë dhe të qartë të shpenzimeve do të ketë në muajt në vijim.

IV. Investime kapitale

Planifikimi i investimeve kapitale për vitin 2018, i detajuar sipas projekteve paraqitet:

000/lekë

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Plani i buxhetit viti 2018	Realizimi (4-mujori I/ 2018)
M630002	Blerje pajisje dhe mobilie zyre	5,000	0

M630013	Blerje pajisje elektronike	900	0
M630021	Software te menaxhimit të çështjeve	2,200	0
M630022	Software aktiviteti financiar	300	0
M630012	Sistemi audio- video sallë gjyqi dhe mbledhje	1,900	0
M630019	Pajisje scanner për kontroll, urë metali dedektor	12,700	0
M630020	Blerje automjeti për institucionin	3,000	0
TOTALI		26,000	

-Sikundër jeni në dijeni, procedurat e prokurimit për blerje automjeti dhe pajisjet e sigurisë, janë deleguar për tu kryer nga Ministria e Brendshme.

-Ka përfunduar procedura e prokurimit është përzgjedhur operatori ekonomik Albanian Motor Company për blerjen e automjetit tip Fuoristradë 4x4, Model SSANGYONG KORANDO, në vlerë 2,554 mijë lekë. Është përcjellë autorizimi i prodhuesit dhe dokumentacioni i tenderit nga Ministria e Brendshme dhe jemi në fazën e lidhjes së kontratës. Afati i lëvrimit të mallit është 10 ditë.

-Për sa u përket skanerit dhe urës dedektor, në përgjigje të interesimit tonë të vazhdueshëm, nga specialistët e Ministrisë së Brendshme jemi informuar se janë skualifikuar të 5 Operatorët Ekonomik (OE) pjesëmarrës në procedurë për shkak të mosplotësimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit. Nga OE ka patur ankesa rreth procesit dhe ende nuk ka një vendimarrje.

-Kanë filluar procedurat e prokurimit për software për mbajtjen e aktivitetit financiar të institucionit.

-Për programin e menaxhimit të çështjes gjyqësore, nëpërmjet Kryetarit të Kolegjit është diskutuar me Komisionerët Publik dhe është rënë dakort në parim për ngritjen e një grupi të përbashkët pune për përcaktimin e nevojave që ky program do të përmbush për të dy institucionet. Gjithashtu i jemi drejtuar në formë elektronike edhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe me marrjen e një përgjigje edhe nga ky institucion, do të veprohet sa më shpejt për draftimin e termave të referencës, për të cilat do tju bëjmë me dije sapo të kemi një kontribut. Në vijim, në varësi të kostove përkatëse si dhe vendimarrjes tuaj, do të procedohet lidhur me këtë program.

Sa i takon zërave të tjerë në investime, në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2018, janë parashikuar për tu realizuar në pjesën e dytë të vitit. Për muajt në vazhdim, me akomodimin dhe fillimin e punës në godinë, do të qartësohen dhe përcaktohen më tej nevojat për pajisje elektronike dhe pajisje apo mobilje të ndryshme si dhe do të vazhdojnë procedurat e prokurimeve.

Duke Ju falënderuar për vëmendjen.